



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më datë 25.04.2025

VENDIM

Nr. 240, datë 25.04.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.04.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit “Gërmimi arkeologjik i shpëtimit për zonën e galerisë me pilastra në Kalanë e Gjirokastrës”, Monument Kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues **DRTK Gjirokastrë, me rekomandimin;**
 - Të vijohet gërmimi jashtë murit rrethues të Kalasë së Gjirokastrës për identifikimin e kullës;
 - Të realizohet një sondazh arkeologjik me përmasa 2x2m në pjesën qendrore të kalasë ku janë identifikuar gjurmët më të hershme të saj;
 2. Rezultati i gërmimit dhe sondazhit arkeologjik, i cili do të realizohet nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik dhe DRTK Gjirokastrë, të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

